



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 05, Datë 10.01.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, *”Për Sektorin e Energjisë Elektrike”*, të ndryshuar; nenit 4, pika 50; nenit 22, pika 2, gërma “ç” dhe nenit 83 të Ligjit Nr. 102/2015 *“Për Sektorin e Gazit Natyror”*; nenit 4, pika 1, gërma “ç”; nenit 5; nenit 8; nenit 9 pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, gërma “e” dhe nenin 10, pikat 1 dhe 4 të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e Gazit Natyror”*, si dhe nenit 15 të *“Rregullave të Organizimit, Funksonimit dhe Procedurave të ERE-s”*, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.01.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 125/2 Prot, datë 27.12.2019, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., me shkresën nr. 3051 prot., datë 12.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 810 prot., datë 12.12.2019, ka aplikuar për pajisjen me licencë në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i Ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993, *“Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen plotësuar nga shoqëritë tregtare”*; Ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991, *“Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe privatizimit”*, i ndryshuar, dhe rezultoi i regjistruar si person juridik shqiptar, me Vendimin e Gjykatës së Tiranës, nr. 674/1 akti, datë 05.07.1993 me numrin e identifikimit (NUIS) J61820031J.
- Objekt i veprimtarisë së saj është: Import eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të: Energjisë Elektrike, Gazit Natyror etj.
- Nga shqyrtimi që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “GSA” sh.p.k., në bazë të nenit 9 të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e liçensave në sektorin e gazit natyror”*, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017, rezultoi si më poshtë vijon:

- Neni 9, pika 1 gërma “a”, “b”, “c” dhe “e”. (Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor)-Plotësuar.
Mungon pjesërisht dokumentacioni i kërkuar bazuar në gërma “d” (. Shoqëria ka paraqitur në ERE statutin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., (vërtetim i njësisë me origjinalin, me nr. Rep. 2945, datë 10.12.2019) dhe mbetet të depozitohet në ERE Aktin e themelimit dhe të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit
- Neni 9, pika 1 gërma “e” (ii) që ka të bëjë me Pasqyrat financiare të audituara. Subjekti “GSA” sh.p.k. ka përcjellë në ERE Pasqyrat financiare të audituara, për vitet 2017 dhe 2018 nga të cilat rezulton një bilanc pozitiv. Nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016.
- Neni 9, pika 1 gërma “e” (vi) Plan biznesi I cili përfshin një analizë të kostove dhe përfitimeve. Nuk ka paraqitur në ERE Planin e Biznesit.
- Neni 9, pika 1 gërma “e” (vii). Nëse Aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore ai duhet të informojë ERE për këtë synim dhe të japë një Garanci të Performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi. Aplikanti nuk ka paraqitur informacion.
- Neni 9, pika 2 (i), (ii), (iii). Subjekti ka bërë përshtypimin e sasisë mesatare të gazit natyror të parashikuar për të livruar, garancinë mbi cilësinë e gazit si dhe dokumentuar kapiatlin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktiviteti, duke plotësuar kërkesat e kësaj dispozite

Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror*”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI